

**UDHËZIM**  
**Nr. 13, datë 13.4.2017**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR PROCEDURAT  
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave,

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Në fund të pikës 106.2.1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për ankimet e paraqitura nga data 1 janar 2017 deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, data e marrjes së ankimit nga Drejtoria e Apelitit Tatimor ose Komisioni është data në të cilën Drejtoria e Apelitit Tatimor ka filluar ushtrimin e funksioneve pranë Ministrisë së Financave sipas legjislacionit në fuqi dhe ankimet janë marrë në dorëzim nga drejtori i Apelitit Tatimor”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Arben Ahmetaj**